



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 611/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Afijete Sada-Glllogjani kryesuese, Ferki Xhaferi dhe Kymete Kicaj anëtare, duke vendosur përkitazi me ankesën e Ymer Ukiqi nga Vushtrria paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Vushtri, për shkak të vendosjes së posterit në hapësirë private, për Zgjedhjet Lokale 2021, që do të mbahen me datë 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 11.10.2021, mori këtë:

VENDIM

KONSTATOHET e tërhequr e ankesa Anr.611/2021 e datës 08.10.2021, e parashtuar nga Ymer Ukiqi nga Vushtrria kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

Arsyetim

Me datën 08.10.2021, Ymer Ukiqi nga Vushtrria, ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se në objektin e tij privat në Vushtri subjekti politik LDK ka vendosur pllakatën e reklamimit pa pëlqimin dhe dijeninë e tij me të cilën pretendon se i është dëmtuar objekti i tij tej mase, përkatësisht kornizat e dritareve të lokalit si dhe vrimat në të cilat është vendosur pllakata.

I njëjti thekson se i është drejtuar gojarisht dhe me kërkesë subjektit politik LDK-së, që të largoj vendosjen e pllakatës dhe të bëjë kompensimin e dëmit material mirëpo nga të njëjtit nuk ka marrë përgjigje fare.

Parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, si dëshmi kësaj ankesë i ka bashkangjitur kërkesën me shkrim drejtuar LDK-së të datës 04.10.2021 si dhe një fotografi të printuar nga vendi i ngjarjes. I ka propozuar PZAP-së që ankesën ta aprovoj si të bazuar.

Ndërsa me datë 08.10.2021, ankuesi ka parashtuar kërkesën me nr. Protokolli Anr.611/3 për tërheqjen e ankesës Anr.611/2021, të datës 08.10.2021 për shkak të vendosjes së posterit në hapësirë private.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës, në kuptim të nenit 11 paragrafi 2 të Rregullën Nr.02/2015 të PZAP-it si dhe nenit 115.1 të LZP -së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.611/2021 më datën 11.10.2021

Kryesuese e Panelit
Afijete Sada-Glllogjani

